

BOTIMI

Profesor i Historisë së Europës orientale në Universitetin e Romës "La Sapienza", Biagini sapo ka botuar në gjuhën shqipe një libër mbi historinë e Shqipërisë. Aty ka folur për figurën e Zogut, bashkëpunimin e komunistëve shqiptarë me ata italianë, historitë e fëmijëve që gjatë pushtimit italian lindën nga prindër shqiptaro-italianë, e që më vonë mbetën si "tokë e askujt"



Botohet libri
"Historia e
Shqipërisë, nga
zanafilla deri në
ditët tona"

Kinezët financojnë italianët

Elementët më ekstremë të Partisë Komuniste italiane, që më vonë do të dalin fare nga kjo parti, financohen nga kinezët përmes Tiranës, për aktivitetet e tyre politike në Itali. Por ka edhe histori interesante në nivelin e "bizneseve të vegjël", por këtë do ta shohim kur të dalë libri.

Antonello BIAGINI: Trazirat e 1997-ës nuk ishin rebelim komunist

Italia fashiste garantoj pavarësinë e Shqipërisë

Fatmira Nikolli

Më shumë se ta lexojmë si një rikthim të komunizmit, 1997-ta mund të lexohet si element i rremujës që vinte në Shqipëri për shkak të vështirësisë për të formuar një qeveri të qëndrueshme ose të problemeve ekonomike. Ajo që ndodhi, nuk erdhi për shkak të komunizmit, as të ideologjisë, por për shkak të problematikës ekonomike dhe zhgënjimit të popullit që mendonin se me ardhjen e demokracisë shumë gjëra do të ndryshonin". Kështu shprehet Antonello Biagini, autor i librit "Historia e Shqipërisë, nga zanafilla deri në ditët tona". Profesor i Historisë së Europës orientale në Universitetin e Romës "La Sapienza", Biagini sapo ka botuar në gjuhën shqipe një libër, ku në bazë të dokumenteve të studiuara sjell historinë e vendit tonë, por të parë me sy të ftohtë, me sytë e një të huaji që përveç profesionit, asgjë nuk e lidh me vendin përballë. Siç tregon gjatë intervistës, në atë botim, Biagini ka folur për figurën e Zogut, bashkëpunimin e komunistëve shqiptarë me ata italianë, historitë e fëmijëve që gjatë pushtimit italian lindën nga prindër shqiptaro-italianë, e që më vonë mbetën si "tokë e askujt". Por, ai hedh edhe idenë se fashistët siguruan pavarësinë tonë, ashtu siç tregon edhe histori të veçanta të bashkëpunimit mes komunistëve, duke treguar se kinezët financonin italianët përmes Tiranës.

Profesor Biagini, ju sapo kemi botuar librin "Historia e Shqipërisë, nga zanafilla deri në ditët tona". Si ju erdhi ideja dhe cilat janë disa nga pikat kryesore tek të

cilat jeni ndalur?

Libri vjen si nevojë, sepse historiografia italiane e kishte braktisur pak temën e studimeve mbi Shqipërinë. Në vitet 1923 historia e Shqipërisë ishte shumë prezente në republikën italiane. Kjo ishte arsyeja e parë pse unë e shkrova këtë libër.

Për këtë libër u mendua se ishte i nevojshëm në mënyrë që të rikujtoje atë që ishte historia e Shqipërisë dhe e popullit shqiptar. Në libër flitet për vendin tuaj që në zanafillë të tij e deri në ditët e sotme; jepet një pamje e plotë e emigracionit të madh shqiptar në kohën e Skënderbeut, por në një farë mënyre jepet edhe epopeja e lëvizjeve të tyre, rrugët nga ikën ata, nga veriu dhe nga jugu. Viti i fundit që përfshihet në libër është viti 2005. Në kapitullin e parë të botimit unë rindërtoj, në një farë mënyre, edhe origjinën e popullit shqiptar sipas legjendave që i përkasin prejardhjes

së shqiptarëve. Janë legjenda të ndryshme që ekzistojnë për lindjen e këtij populli, legjenda për ardhjen e tyre nga Polonia apo nga Afrika Veriore. Pas tyre, unë kam vënë të dhënat konkrete, sipas të cilave populli shqiptar është një prej atyre popujve që ka banuar prej kohësh në këto troje të Ballkanit. Duke pasur parasysh të dhënat, shqiptarët kanë qenë në këto koordinata gjeografike aktuale por në një hapësirë më të madhe seç janë tani. Preket edhe problemi i Shqipërisë së madhe që iu ndryshuan kufijtë pas luftërave. Kam folur edhe për një karakteristikë të veçantë që kanë shqiptarët, është ajo e strukturës sociale. Ka të bëjë me format e jetës të llojit të tribuve, organizimi i shtetit ku në një farë mënyre ndjehet tradita. Diskutohet edhe problemi i administrimit të drejtësisë, ose vetëdrejtësisë, edhe ky është një nga problemet shqetësuese. Por këto janë në funk-

sion të dickaje, janë në funksion të avancimeve të Shqipërisë në proceset që i duhen asaj për hyrjen në Europë. Nëse ky libër është një lloj shfaqjeje, nuk vjen si meritë apo vullnet i historianëve, studiuesve apo antropologëve, por janë shfaqje që ndihmojnë për t'u përgatitur për Bash-

kimin European. Por për BE-në, sistemi i drejtësisë është mjaft i rëndësishëm, sepse kanë të bëjnë me të drejtat njerëzore. Ndaj, aspektet jo pozitive të traditës që ekzistojnë dikur, nuk janë më vetëm kuriozitetet historike por edhe elemente që duhen modifikuar për të çuar vendin në një nivel administrimi, nivel institucionesh, në nivelin ekonomik që është i përshtatshëm për hyrjen në BE. Ky është qëllimi kulturor i këtij volumi. Në libër janë prekur disa momente ekonomike të Shqipërisë parakomuniste, është folur për zhvillimin që italianët



Fashistët

"Ajo periudhë mes dy luftërave ka një pjesë interesante, do të thosha unë, sepse tutela nën të cilën Italia ka vënë Shqipërinë, në një farë mënyre i garanton edhe pavarësinë këtij vendi, që nuk kishte shumë kohë që e kishte shpallur atë"

Në foto:
Kopertina e librit në Italisht (lart djathtas)
Kopertina e librit në shqip (lart majtas)
Antonello Biagini